



VENDIM

Nr. 53 Datë 03 .05.2013

**PËR
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË EMIKEL 2003 SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 gërma”b”, pika 3 pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03 .05.2013, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

- Ankesa e paraqitur nga subjekti “Emikel 2003” shpk, është brenda afateve ligjore të vendosura nga ERE (afate të percaktuara në nenin 16, pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 ”Per Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, gjithashtu të percaktuar dhe në nenin 10, pika 11, të Rregullores për “Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plote/të pjesshem dhe Rinovimit të Liçensave“.
- Aktiviteti i Prodhimit të Energjisë Elektrike, procedure e cila ndiqet nga ERE, detyrimisht lidhet me pasjen në pronësi të asetëve Hec (të cilat janë objekt gjykimi në çështjen civile mes paleve)
- Akti Administrativ i Liçensimit në Aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike, është një akt administrativ, që ka pasoja të drejtperdrejta mbi asetin perkatese (konkretisht Hec Tucep).
- Shoqëria Emikel 2003 sh.p.k në marrëveshjen e shtesës së koncesionit e lidhur me METE me datën 3 Prill 2013 ka hequr dorë nga cdo e drejtë dhe detyrim mbi HEC Tucep.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Modifikimin e liçensës së shoqërisë “Emikel 2003” sh.p.k, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec-et “Lenie”, “Çorovodë” dhe “Tucep”.
2. Ne gjithë tekstin e liçensës së shoqërisë Emikel 2003 sh.p.k hiqet fjala “Hec Tucep” me kapacitet 0.4 MW, kudo ku është shkruar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI

Ne mungese dhe me porosi

Entela SHEHAJ

